



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 768/Prot  
4

Tiranë, më 01/10/2015

V E N D I M

Nr. 40, datë 01/10/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, "**DORO GROUP**" sh.p.k.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 172, datë 04/09/2015 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "**DORO GROUP**" sh.p.k, me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

Në kuadër të zbatimit të plotësimit të detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar, Kontrolluesi "**DORO GROUP**" mbledh dhe për këtë arsye përpunon të dhëna imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave punonjës dhe klientë, nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV).

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ rezultoi se kontrolluesi nuk kishte vendosur tabela informuese për kamerat sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin e mësipërm. Në gjithë ambjentin e kontrolluesit u evidentuan dy tabela shumë të vogla, të vendosura në vende të papërshtatshme dhe nuk arrinin qëllimin e informimit. Tabelat nuk e informojnë subjektin e të dhënave mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, dhe nuk i jep mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin në rast ankesash.

Në lidhje me plotësimin e detyrimit për njoftim, kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me



aktivitetin e tij. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, u konstatua se ky subjekt nuk e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të ligjit.

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ, më datë 07/09/2015, përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se formularin e njoftimit e kishte plotësuar dhe dërguar në vitin 2010, për të vërtetuar pretendimin e tij paraqiti një fotokopje të formularit të njoftimit të plotësuar i cili mban datën 19.09.2010, por nuk paraqiti asnjë provë që ky formular të jetë dorëzuar pranë KDIMDP-së.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", në datë 23/09/2015 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesi i *DORO GROUP* sh.p.k Z. Jorgo Naumi paraqiti:

- Fotokopje e formularit të njoftimit;
- Pretendime, datë 23.09.2015;
- Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ekstrakt i QKR-së;
- Çertifikatë Regjistrimi të personit të tatueshëm;
- Çertifikatë klasifikimi të njësisë akomoduese turistike.

Përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi që "*Formularin e njoftimit e kam plotësuar dhe dërguar me postë që në vitin 2010. Këtë pretendim e mbështes duke u vënë në dispozicion një kopje të tij e cila mban datën 09.09.2010.*

*Sa i përket tabelave informuese të vendosura për kamerat, me qëllim informimin e subjektit të të dhënave për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit deklaroi se aktualisht janë vendosur sipas modelit të duhur".*

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, u evidentua se fotokopje e formularit të njoftimit e paraqitur nga përfaqësuesi i kontrolluesit Z. Jorgo Naumi gjatë seancës, nuk është e njëjtë me atë të paraqitur po nga Z. Naumi gjatë hetimit administrativ. Fotokopje e formularit mban të njëjtën datë 09.09.2010 me fotokopjen e formularit të dorëzuar ditën e inspektimit. Nga përmbajtja, të dy formularët e paraqitur nga kontrolluesi me pretendimin se janë dërguar me postë gjatë vitit 2010, janë njësoj, por jo nga formati. Për të vërtetuar se detyrimi ligjor për të njoftuar është realizuar nga ana e tij, kontrolluesi për të njëjtin qëllim ka paraqitur dy prova që bien në kundërshtim me njëra tjetrën dhe vërtetojnë të kundërtën.

Sa më sipër, grupi i hetimit administrativ konstaton se nga verifikimet e kryera në regjistrin elektronik, në protokollin e Zyrës së Komisionerit dhe pasi u shqyrtuan në provat e paraqitura më sipër, rezulton që pretendimi sipas të cilit kontrolluesi e ka plotësuar dhe dërguar formularin që prej vitit 2010 nuk qëndron. Kontrolluesi është përpjekur të mbulojë faktin që nuk e ka zbatuar detyrimin ligjor për të njoftuar duke paraqitur dy fotokopje të ndryshme të formularit të njoftimit. Detyrimi ligjor për të njoftuar nuk është zbatuar nga ana e tij.

Subjekti kontrollues "*DORO GROUP*" sh.p.k sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është krijuar dhe ushtron aktivitetin e tij që prej datës 25.04.1992. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është miratuar dhe



botuar në Fletoren Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës, është bërë i njohur për të gjithë publikun dhe është i detyrueshëm për zbatim.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

Gjithashtu, bazuar në nenin 25/1 të ligjit të sipërcituar, parashikohet që kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë zyrën e Komisionerit. Me miratimin e ligjit, kontrolluesi nuk duhet të vazhdojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar Zyrën e Komisionerit. Shkelja e konstatuar, lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, cilat janë të dhënat që përpunohen, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" e Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë.

Personat juridikë, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjen e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si edhe reagimin e kontrolluesit për shkeljet e konstatuara.

#### PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "**DORO GROUP**" sh.p.k me gjobë, në vlerën **300 000 (treqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot në, 01/10 / 2015

